

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtaren Franciska Zhitia-Ymeri duke vendosur lidhur me çështjen juridike të paditëses B. P. B. (BpB) me seli në P., të cilën e përfaqëson sipas autorizimit I. Q. jurist nga P., kundër të paditurve NTP “P.”, NT “P.1” dhe NTSH “D.c.” që të tre me seli në Gj., të cilët i përfaqëson sipas autorizimit E. Q. avokat nga Gj. dhe R. I. me vendbanim në fshatin V., Komuna e Gj., me objekt kontesti për kthimin e borxhit, në shumë të përgjithshme prej 166,132.10 euro, në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 24.04.2017, në prani të të autorizuarit të paditësit si dhe në prani të autorizuarit të paditurve, ndërsa me datën 05.05.2017 merr këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses B. P. B. (BpB) me seli në P..

I. DETYROHEN në mënyrë solidare që të paditurit NTP “P.”, NT “P.1” dhe NTSH “D.-c.” që të tre me seli në Gj., që në emër të borxhit t’ia paguajnë paditësit shumën e përgjithshme prej 166,132.10 euro (njëqind e gjashtë dhjetë e gjashtë mijë e një qind e tridhjetë e dy euro e dhjetë cent) me kamatë të cilën e paguajnë bankat vendore si për mjetet e deponuara në kursim me afat mbi 1 vit e pa destinim të caktuar, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë 21.03.2013 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afatin partitiv prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

II. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë si e pabazuar në shumën prej 368,755.11 euro.

III. KONSTATOHET se paditësja e ka tërhequr padinë ndaj të paditurit R.I. nga Gj..

IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale veç e veç.

A r s y e t i m

Paditësja B. P. B. (BpB) me seli në P., ka parashtruar me datën 21.03.2013, padi ndaj të paditurëve NTP “P.”, NT “P.1” dhe NTSH “D.-c.” që të tre me seli në Gj., dhe R. I. me vendbanim në fshatin V., Komuna e Gj., duke kërkuar që të paditurit t’ia paguajnë borxhin në emër shumës së papaguar për kredi në shumën e përgjithshme 534,887.21 euro, me kamatë të cilën e paguajnë bankat vendore si për mjetet e deponuara në kursim me afat mbi një vit e pa destinim të caktuar duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë 21.03.2013 e deri në pagesën definitive, njëherit i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

I autorizuari i paditësit gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka mbetur pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke shtuar se me të paditurin kanë lidhur marrëveshje mbi kredinë me nr.150/04 me datë 19.04.2004, për kredin e lejuar në shumë prej 370,000.00 euro, dhe se kjo marrëveshje është siguruar me sendet e paluajtshme me të cilat kanë qenë kushte për lëshimin e kredisë dhe mbitërheqjen, mirëpo e paditura (debitori) në cilësinë e

kredimarrësit dhe garantuesve të produkteve kreditore të lartpërmendura, nuk i janë përmbajtur obligimeve të cilat i kanë marrë me marrëveshjet e lartpërmendura kështu që e paditura nuk i ka kryer obligimet. Andaj i autorizuari i paditësës ka kërkuar nga gjykata që padija të aprovohet në tërësi si e bazuar.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

Të paditurit përmes përgjigjes në padi dhe i autorizuari i tyre gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit sa i përketë lartësisë së borxhit por nuk e ka kundërshtuar borxhin e papaguar në shumën prej 166,132.00 euro, andaj ka kërkuar nga gjykata që padia e paditësës të refuzohet si e pa bazuar mbi këtë shumë të ofruar.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe i ka specifikuar.

Gjykata ka administruar provat e propozuara nga palët në procedurë dhe atë: lejimi i kredisë i datës 20.07.2004, kërkesë për kredi dhe garancion pa datë kontrata mbi kredinë me nr. 1500/04 e datës 20.07.2004, certifikata e regjistrimit me nr. 70039272, marrëveshja mbi kolateralin e datës 20.07.2004, masat e sigurisë të datës 20.07.2004, pro faturë me nr. 08-04 e datës 25.07.2007, deklarata garantuesit e datës 09.07.2004, fletë regjistrimi i datës 07.07.2007 deklarata e garantuesit 09.07.2004, certifikata e biznesit të Dizajn -Com me nr.80641834, fletë regjistrimi 07.07.2004, kontrata mbi hipotekë me nr. 150/04 e datës 20.07.2004, shkresë e Gjykatës komunale në Gjilan e datës 21.07.2004 aktvendimi i Gjykatës Komunale në Gjilan me nr. INT 239/04 e datës 21.07.2004, aktvendimi i gjykatës komunale në Gjilan INT nr. 236/04 e datës 21.07.2004, vërtetim i datës 21.07.2004, certifikatë pronësie me nr. 1232/2013 e datës 06.02.2013, kartela e qarkullimit e datës 21.03.2013, ekspertiza financiare e ekspertit A. G. e datës 15.04.2016, qarkullimi për llogari prej datës 06.07.2004 deri me 04.03.2016, plotësimi i ekspertizës e datës 19.07.2016, qarkullimi për llogari 06.08.2004, plotësimi i ekspertizës i datës 30.11.2016, fletëtërheqja e datës 06.08.2004, ekspertiza e grafologjisë e datës 23.03.2017.

Provat e propozuara dhe të administruara, deklaratimet e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse dhe ekspertizat gjyqësore, gjykata i vlerësoi, të gjitha një nga një dhe në varësi me njëra tjetrën, në vështrim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe gjeti se:

Në mes palëve në procedure kontestimore nuk ishte kontestuese marrëdhënja afariste e as borxhi ashtu siç e pohojn edhe vet të paditurit, por kontestuese ishte sa ka mbetur e paditura borxh paditësit gjegjësisht lartësinë e borxhit.

Në bazë të provave të administruara gjykata ka vërtetuar faktin se palët në procedurë kanë qenë në marrëdhënje detyimore kontraktuese, ku kanë arritur lidhjen e marrëveshjes mbi kredinë me nr.150/04 me datë 19.07.2007, në vlerë prej 370,000.00 euro, dhe me këto marrëveshje palët kontraktuese janë pajtuar me kushtet të cilat i përmban këtë marrëveshje, po ashtu edhe për kundër marrjes së kredisë të paditurit nuk iu kanë përmbajtur obligimeve të tyre.

Gjykata për ta vërtetuar çështjen kontestuese lidhur me këtë kontest ka aprovuar propozimin e palës së paditur për caktimin e ekspertit financiar nga lista e ekspertëve gjyqësor, ku sipas mendimit dhe konstatimit të ekspertizës financiare dhe plotësimit të ekspertizës së datës

15.04.2016, nga eksperti A.G. gjykata ka vërtetuar faktin se të paditurit i kanë mbetur borxh paditësit shumë prej 166,132.10 euro, duke përfshirë principalin dhe interesin e rregullt jashtbilancor. Këtë konstatim ekspertit ka arritur duke marrë parasysh vlerat e borxhit mbi bazën e kredisë së marrur, borxhi total për kredi, borxhi i mbetur për kredi dhe shuma e interesit për vonesë, të gjitha në mënyrë tabelare i ka paraparë dhe ka ardhur në përfundim se borxhi i mbetur dhe i papaguar është 166,132.10 euro dhe atë duke zbritur shumë prej 98,500.00 euro për arsye se kjo shumë nuk është argumentuar se është terhequr nga i padituri S. V. andaj edhe një shumë e tillë nuk është njohur dhe as aprovuar nga ana e gjykatës.

Gjykata për ta vërtetuar çështjen kontestuese lidhur me nënshkrimin e dhënë në fletëterheqjen e datës 06.08.2004 nga S. V., ka aprovuar propozimin e të autorizaurit të paditurve që të nxirret prova me anë të ekspertizës së Grafologjisë, ku sipas mendimit dhe konstatimit të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë nga ekspertet F. S. dhe H. B. kanë dhënë mendim dhe konstatimin se nënshkrimi i dhënë në fletëterheqjen e datës 06.08.2004, si dhe mostrat e njohuara në krahasim me nënshkrimin e tij në kontratën mbi kredinë të nënshkruar me datë 20.07.2004, me nënshkrimin e dhënë në autorizimin me datë 18.11.2014 si dhe me 20 nënshkrimet të nënshkruara në mostra para gjykatës, nuk janë të nënshkruara nga i njëjti person.

Gjykata i besoi mendimit dhe konstatimit të raportit të ekspertimit nga Grafologjia se fletëterheqja e datës 06.08.2004, në shumë prej 98,500.00 euro, në krahasim me mostrat e njohura nuk janë të nënshkruara nga i njëjti person përkatësisht fletëterheqja nuk është e nënshkruar nga i padituri S. V. ashtu siç ka pretenduar pala paditëse.

Gjykata ka refuzuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë në shumë 98,500.00 euro, për arsye se nuk ka prova bindëse se këtë shumë e ka terhequr i padituri S. V., këtë konstatim gjykata e mbështet në mendimin dhe konstatimin e ekspertizës së Grafologjisë për arsye se fletëterheqja e datës 06.08.2004, nuk është e nënshkruar nga S. V. ashtu edhe siç është konstatuar dhe nga ekspertiza e lartëcekur, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë e kërkuar me padi në shumë prej 270,255.11 euro, gjykata e refuzoi për shkak se nuk ka mbështetje në prova, andaj gjykata vlerësoi se ekspertiza financiare e punuar nga eksperti A. G. e datës 15.04.2016, është profesionale dhe e argumentuar mirë, e mbështetur në prova materiale të njëjtën e ka pranuar në tërësi si të besueshme, andaj edhe vendosi si në dispozitivin e II-të, të këtij aktgjykimi.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 17 të LMD-së me të cilën parashihet se “pjesëmarrësit në marrëdhënjet detyimore janë të obliguar të përmbushin detyrimet e veta sic janë marrëveshje dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij” dhe nga kjo del se paditësi nuk e ka përmbushur detyrimin sic është paraparë në marrëveshje, po ashtu Gjykata u bazua edhe në nenin 1065 të LMD-së, ku parashihet se” me kontratën e kredisë banka detyrohet që shfrytëzuesit të kredisë t’i vënë në dispozicion shumë e kontraktuar të mjeteve në të holla, në kohë të caktuar apo të pacaktuar, për ndonjë destinim të caktuar ose padestinim të caktuar, ndërsa shfrytëzuesi i kredisë detyrohet që bankës t’ia paguan kamatën e kontraktuar dhe shumë e marrë të të hollave t’ia kthejë në kohën dhe mënyrën e përcaktuar me kontratë”.

Edhe me nenin 1004.3 të LMD-së është përcaktuar se “dorëzanësi për detyrimin e lindur nga kontrata në ekonomi përgjigjet si dorëzanës pagues në qoftëse nuk është kontraktuar diqka tjetër”, për faktin se pala kredimarrës nuk e ka përmbushur detyrimin e vet në tërësi sipas

kontratës, paditësi në pajtim me nenin 262 dhe neni 1004.3 të LMD-së, ka kërkuar përmbushjen e detyrimit dhe nga të paditurit të tjerë si debitorë solidar.

Paditësja në seancën e datës 20.11.2014 e ka tërheqë padinë ndaj të padituri R. I.-bashkë kredi marrës, nga Gj., për arsye se i njëjti ka vdekur andaj duke pasur parasysh rrethanat e lartë cekura, konstatohet paditësja e ka tërhequr padinë ndaj të paditurit R. I. në këtë çështje civile juridike konform nenit 261.1, 261.3 dhe 261.4 të LPK-së.

Gjykata vlerësoj edhe pretendimin e paditësit se fletëtërheqja në shumën prej 98,500.00 euro, është nënshkruar nga i padituri S. V. por gjykata e refuzoj sit ë pabazuar për shkak se ekspertiza e grafologjisë ka vërtetuar se fletërheqja e datës 06.08.2004, e njëjta nuk është e nënshkruar nga i padituri S. V., andaj edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Meqenëse të paditurit, kanë rënë në vonesë lidhur me pagesën e borxhit të krijuar, duke u bazuar në nenin 277 të LMD-së, gjykata e detyroj të paditurën që tia paguaj paditësit, shumën e gjykuar së bashku me kamatën të cilën e paguajnë bankat vendore si për mjetet e deponuara në kursim me afat mbi 1 vit e pa destinim të caktuar duke filluar nga parashtrimi i padisë, ndërsa refuzohet llogaritja e kamatës mbi kamatë për kamatëvonesën, bazuar në nenin 279 të LMD-së.

Duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e lartëcekura dhe në dispozitat ligjore të cituara më lartë, gjykata konstatoi se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar pjesërisht andaj edhe u aprovua si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore gjykata është bazuar në dispozitën e nenit 450 të LPK-së. Andaj nga të lartë cekurat gjykata vendosi si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Pas shqyrtimit të të gjitha provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës gjykata ka vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi duke u bazuar në nenin 17, 1065, 1004.3 të LMD-së, si dhe nenin 143 paragrafi 1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
-Departamenti për Çështje Ekonomike-
III.EK.nr.144/13 me datë 05.05.2017

Gjyqtarja
Franciska Zhitia-Ymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Ndaj këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta e ankesës në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve, duke llogaritur nga dita e pranimit të tij duke iu drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.